

**DIREKTIVA NR. 79/7/KEE, “MBI ZBATIMIN PROGRESIV TË PARIMIT
TË TRAJTIMIT TË BARABARTË TË BURRAVE DHE GRAVE
NË ÇËSHTJET E SIGURIMIT SHOQËROR”**

19 dhjetor 1978

Këshilli i Komuniteteve Evropiane,

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Komunitetit Ekonomik Evropian, në veçanti nenin 235 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit,

Duke pasur parasysh opinionin e Parlamentit Evropian,

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social,

Ndërkohë që neni 1 (2) i Direktivës së Këshillit nr. 76/207/KEE, e datës nëntë shkurt njëmijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë “Mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave përsa i takon të drejtës për punësim, formimit profesional dhe ngritjes në detyrë, si dhe kushteve të punës”, përcakton që, në mënyrë që të sigurohet zbatimi progresiv i parimit të trajtimit të barabartë në çështjet e sigurimit shoqëror, Këshilli, me propozim të Komisionit, do të miratojë dispozita që përkufizojnë thelbin dhe qëllimin e tij si dhe masat për zbatimin e këtij parimi;

Ndërkohë që Traktati nuk ofron kompetencat e nevojshme të kërkuara për këtë qëllim;

Ndërkohë që parimi i trajtimit të barabartë në çështjet e sigurimeve shoqërore duhet të zbatohet, në radhë të parë, në skemat ligjore të mbrojtjes nga rreziqet e sëmundjes, invaliditetit, pleqërisë, aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale dhe papunësisë, dhe në skemat e asistencës sociale për aq kohë sa ato synojnë të plotësojnë ose zëvendësojnë skemat e mësipërme;

Ndërkohë që zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në çështjet e sigurimit shoqëror nuk cenon dispozitat që lidhen me mbrojtjen e grave gjatë shtatzënisë;

Ndërkohë që, në këtë aspekt, shtetet anëtare mund të miratojnë dispozita të veçanta për gratë në mënyrë që të zhduken rastet ekzistuese të trajtimit të pabarabartë,

Ka miratuar këtë Direktivë:

Neni 1

Qëllimi i kësaj Direktive është zbatimi progresiv, në fushën e sigurimeve shoqërore dhe të elementeve të tjerë të mbrojtjes sociale të parashikuar në nenin 3, i parimit të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e sigurimit shoqëror, që tani e tutje do të referohet si “parimi i trajtimit të barabartë”.

Neni 2

Kjo Direktivë do të jetë e zbatueshme për popullsinë aktive për punë, përfshirë personat e vetëpunësuar, punëtorët dhe personat e vetëpunësuar veprimtaria e të cilëve është ndërprerë nga sëmundja, aksidenti apo papunësia jo e dëshirueshme dhe personat që janë në kërkim të punës, si dhe për punëtorët, të vetëpunësuar ose jo, që kanë dalë në pension pleqërie apo invaliditeti.

Neni 3

Kjo Direktivë do të zbatohet për:

a. skemat ligjore që garantojnë mbrojtjen ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- sëmundje,
- invaliditet,
- pleqëri,
- aksidente në punë dhe sëmundje profesionale,
- papunësi,

b. asistencë sociale, për aq kohë sa ato synojnë të plotësojnë ose zëvendësojnë skemat e referuara në pikën a.

2. Kjo Direktivë nuk do zbatohet për dispozitat që kanë lidhje me përfitimet e të mbijetuarve dhe as për ato që kanë lidhje me përfitimet familjare, përveç rasteve kur këto përfitime familjare vijnë si rrjedhim i rritjes së përfitimeve të lidhura me rreziqet e përmendura në paragrafin 1 (a).

3. Me qëllim që të sigurohet zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në skemat e punësimit, Këshilli, me propozim të Komisionit, do të miratojë dispozita që përkufizojnë thelbin dhe qëllimin e tij si dhe masat për zbatimin e këtij parimi.

Neni 4

1. Parimi i trajtimit të barabartë nënkupton që nuk do të ketë asnjë lloj diskriminimi, të drejtpërdrejtë ose jo, për shkak të gjinisë, duke iu referuar në mënyrë të veçantë gjendjes martesore ose familjare, sidomos përsa i përket:

- zbatueshmërisë së skemave dhe kushteve të hyrjes në to,
- detyrimit për të derdhur kontributet dhe llogaritjes së tyre,
- llogaritjes së përfitimeve, përfshirë rritjet që i takojnë bashkëshortit/bashkëshortes, dhe për personat në varësi, si dhe kushteve që rregullojnë kohëzgjatjen dhe të drejtën e përfitimeve.

2. Parimi i trajtimit të barabartë nuk do të cenojë dispozitat që lidhen me mbrojtjen e grave për shkak të amësisë.

Neni 5

Shtetet anëtare do të marrin masat e nevojshme për të siguruar shfuqizimin e çdo ligji, rregulloreje dhe dispozite administrative në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë.

Neni 6

Shtetet anëtare do të përfshijnë në sistemet e tyre ligjore kombëtare të gjitha masat e nevojshme për tu mundësuar të gjithë personave, që e konsiderojnë veten padrejtësisht të përjashtuar nga zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në aktivitetet vetëpunësues, që të kërkojnë pretendimet e tyre edhe nëpërmjet procesit gjyqësor, mundësisht pas ankimit pranë autoriteteve të tjera kompetente.

Neni 7

1. Kjo Direktivë nuk cenon të drejtën e shteteve anëtare për të përjashtuar nga qëllimi i saj:

a. përcaktimin e moshës për përfitimin e pensioneve dhe ndikimet e mundshme mbi përfitimet e tjera;

b. përparësitë që mund tu jepen në skemat e pensioneve të pleqërisë, personave që kanë rritur fëmijë; fitimin e së drejtës për përfitime pensioni pas periudhave të ndërprerjes së punës për shkak të rritjes së fëmijëve;

c. dhënien e pensioneve të pleqërisë apo invaliditetit që rrjedhin nga e drejta e bashkëshortes;

d. dhënien e rritjeve të pensionit të invaliditetit afatgjatë, pleqërisë, aksidenteve në punë, dhe sëmundjeve profesionale, kur përfituesi ka një grua në varësi;

e. pasojat e ushtrimit, para miratimit të kësaj Direktive, të një të drejtë të personit për të mos kërkuar të drejta dhe për të mos pasur detyrime sipas një skeme ligjore të sigurimeve shoqërore.

2. Shtetet anëtare do të shqyrtojnë periodikisht çështjet e përjashtuara në paragrafin 1, me qëllim që të sigurohen se, duke pasur parasysh zhvillimet sociale lidhur me çështjen në fjalë, ka ende arsye për të mbajtur përjashtimet në fjalë.

Neni 8

Shtetet anëtare do të miratojnë ligje, rregullore dhe dispozita administrative të nevojshme për zbatimin e kësaj Direktive, brenda gjashtë viteve nga njoftimi i saj. Shtetet anëtare do të informojnë menjëherë Komisionin për masat e marra për zbatimin e kësaj Direktive.

Shtetet anëtare do t'i komunikojnë Komisionit tekstin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative që ato do të miratojnë në fushën e mbuluar nga kjo Direktivë, përfshirë masat e marra në zbatim të nenit 7 (2). Shtetet anëtare do të informojnë Komisionin mbi arsyet për mbajtjen e ndonjë mase ekzistuese në lidhje me çështjet e përmendura në nenin 7 (1), dhe mbi mundësitë e rishikimit të këtyre masave në një datë të mëvonshme.

Neni 9

Brenda shtatë viteve nga njoftimi i kësaj Direktive, shtetet anëtare do t'i dërgojnë Komisionit çdo informacion të nevojshëm për të bërë të mundur hartimin e një raporti mbi zbatimin e kësaj Direktive. Raporti do t'i paraqitet Këshillit dhe do të propozohen, sipas nevojës, masa të mëtejshme për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Neni 10

Kjo Direktivë i adresohet shteteve anëtare.